



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 28 Prot.

BASHKIA VAU DEJËS

Vau-Dejes me 04.01.2019

VENDIM

Nr. 92 Date 24/11 2019

“ Per miratimin e buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2020-2022, numrin e punonjesve per Bashkine Vau-Dejes ”

Keshilli i Bashkise Vau Dejes ne mbledhjen e tij te dates 24.12.2019 , me propozim te Kryetarit te Bashkise, mbeshtetur ne nenin 9 pika 1.3, shkronja “c”18,34,40.41,54 shkronja dh,55 pika 3 te ligjit nr, 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” kreu III nenet 10-20, kreu i IV ,nenet 22-29,kreu VII,nenet 39-41, ne nenenin 34 te ligjit te ligjit 68/2017, “Per financat e veteqeverisjes vendore” te ligjit -Nr.9936 datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë,te ndryshuar” ligjin nr, 10296, date 08,07,2010, “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” , te ndryshuar, Udhezimit të Ministrise se Financave Nr.23, date 30.07.2018 “Per procedurat standarte të pregatitjes sëprogrameve buxhetore afatmesem të NJQV”,Udhezim plotesues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr, 7 datë27,02,2019”Për pregatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022”paragrafi I pika 11, dhe shtojcat plotesuese. dhe shtojcat plotësues(Shtojcat e programit buxhetorafatmesem 2020-2022 nga 1-5 si afatmesem mbi nivelin e transfertes së pakushtezuar dhe specifike për njësitë e veteqeverisjes vendore,formati I pregatitjes së relacionit shqerues së programit buxhetor afatmesëm 2020-2022,formati për treguesit orientues të performances për cdo program, Grupi për menaxhimin Strategjik. EKIPI I Menaxhimit të programit si dhe roli I tyre,treguesit makroekonomik e fiskalë,pema e programit si dhe instrumenti I planifikimit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e veteqeverisjes vendore), me shkrese hyrese në Bashkine Vau Dejes nr, prot 1186 datë 05.03.2019

Ne Udhezimin plotesues nr, 20, date 10/07/2019,“Per pregatitjen e buxhetit vendor “ne shkresen nr, 20458 date 11/11/2019 , “ Dergohet per njoftim transferta e pakushtezuar e pergjithshme dhe sektoriale per vitin 2020”,Pas diskutimeve .



VENDOSI

1. Miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtarë për vitet 2020-2022 të Bashkisë Vau Dejës si më poshtë:

a. Të miratojë fondet buxhetore, të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitet 2020-2022, të ndara në korrente dhe kapitale, sipas tabelës nr. 1 pjesë përberëse e këtij vendimi.

b. Të miratojë tavanet për çdo program, për vitin 2020-2022 të programit buxhetor afatmesëm sipas tabelës F6 të (instrumenti i planifikimit financiar) pjesë përberëse e këtij vendimi.

c. Të miratojë të ardhurat sipas përputhshmërisë me rregullat fiskale në fuqi dhe shpenzimet e ardhshme, sipas tabelës F1 dhe F6 të FPT, pjesë përberëse e këtij vendimi.

d. Të miratojë numrin e punonjësve të bashkisë Vau Dejës dhe institucioneve në varesi për vitin 2020, sipas tabelës nr. 2 pjesë përberëse e këtij vendimi.

e. Të miratojë detajimin e shpenzimeve sipas klasifikimeve buxhetore për vitet 2020-2022 sipas tabelës F10 të FPT, pjesë përberëse e këtij vendimi.

f. Të miratojë listen e projekteve të investimeve publike, për çdo program sipas tabelës F15 DHE E3 të FPT, pjesë përberëse e këtij vendimi.

2. Tabelat shoqeruese:

a. Projektin e parë të planit të arkës të ardhurave të veta të vitit 2020, sipas tabelës nr. 6 pjesë përberëse e këtij vendimi.

b. Një përmbledhje e pagesave të vonuara ndaj paleve të treta, përfshirë edhe origjinen e tyre dhe masat për likuidimin e parandalimin e krijimit të tyre, sipas tabelës 7, pjesë përberëse e këtij vendimi.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij buxheti Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015.

5. Ky vendim u shpall me datë 31 / 12 / 2019



SEKRETARI

Ardian CELEPIA

KRYETARI

Mark BISHA